



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministria e Zhvillimit Ekonomik shpallë **KONKURS PËR AVANCIM** të nëpunësve civil për këtë vend të punës:

Departamenti i Minierave

Numri i konkursit: APF0001657

Vendi i punës: Drejtor i Departamentit të Minierave - EZHE/020 / JP00020085

Koeficienti : 10,00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Sekretari i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqë dhe organizon veprimtarin e Departamentit (20%);
- Menaxhon, organizon dhe monitoron punën e stafit, propozon dhe mbikëqyrë hartimin e dokumenteve të politikave/strategjisë për Sektorin minerar (15%);
- Koordinon, propozon dhe mbikëqyrë hartimin e projektligjeve, rregulloreve dhe udhëzimet administrative për sektorin minerar (15);
- Analizon dhe vlerëson proceset, objektivat dhe zbërthen detyrat e departamentit për zbatimin e planit dhe programit të Ministrisë (10%);
- Zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave të sektorit minerar dhe analizon realizimin e detyrave të planit të Punës (10%);
- Siguron bashkëpunimin e Departamentit të Minierave me Departamentet tjera për hartimin e dhe përgatitjen e politikave dhe legjislacionit për sektorin minerarë (5%);
- Monitoron punën për përgatitjen e planeve për zhvillimin e komuniteteve të ndikuara nga aktivitetet minerare (5%);

- Propozon dhe mbikëqyrë zhvillimin e promovimit të resurseve minerale (5%);
- Zhvillon dhe mbanë kontaktet me institucionet qeveritare dhe organizatat tjera të sektorit Minerar (5%);
- Identifikon dhe paraqet problemet të cilat paraqiten gjatë punës në Departament dhe propozon mundësit dhe mënyrat e zgjedhjes për punët e caktuara (5%).
- Vlerësimi i rregullt i punëve të realizuara dhe stafit (5%)

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë Universitare nga lëmia e Gjeoshkencave- Minerave, të ketë së paku 7 vite përvojë pune duke përfshirë katër (4) vite përvojë pune në vende udhëheqëse;
- Aftësi të larta menaxheriale, komunikuese dhe punë ekipore;
- Aftësi në ndërmarrjen e iniciativave;
- Njohuri e legjislacionit përkatës vendor dhe ndërkombëtar për lëmin e xehetarisë, përpunimit, shfrytëzimit dhe plasmanit të produkteve minerale;
- Aftësi të avancuara me kompjuter MS Windows, MS Office (Word, Excel, Power Point, Project, Outlook);
- Aftësi komunikimi (shkrim dhe prezantim oral) në gjuhën Shqipe ose serbe, njohja e gjuhës angleze është përparësi,
- Aftësi të punon në mënyrë efektive në mjedisin multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Aftësi të punon në nivelin më të lartë të konfidencialitetit dhe transparencës;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT PER AVANCIM

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunës civil ekzistues në MZHE, te cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. MZHE ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MZHE-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës, dy vlerësimet e fundit të punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

Afati i konkurrimit është prej datës 19/12/2016 deri me date 26/12/2016, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524